



"Ministero dell'Istruzione, dell'Università e della Ricerca"
 I.C.S. "Quintino Di Vona"
 Via L. da Vinci, 2 - 20062 Cassano d'Adda (MI)
 Cod. Min. MIIC8CC00P - C.F. 91548230159
 tel. 0363/60061 - fax 0363/361145 - e-mail: MIIC8CC00P@istruzione.it
 sito internet: www.icqdivona.it

INFORMATIVA MBI PRIVATËSINË E NXËNËSVE INFORMATIVA PRIVACY AGLI ALLIEVI

Përgatitur në bazë të neneve 13 deri 15 të rregullores së B.E. 2016/679 (G.D.P.R.)

Para se Ju të na jepni të dhënat tuaja personale, në zbatim të Rregullores Europiane për mbrojtjen e të dhënave personale, është e këshillueshme që të lexoni një seri informacionesh që mund t'ju ndihmojnë të kuptoni arsyet pse të dhënat tuaja do të përpunohen dhe cilat janë të drejtat që mund të ushtroni në lidhje me këtë trajtim.

Për çfarë qëllimi do të përpunohen të dhënat e mia personale?	Përpunimi i të dhënave personale të nevojshme, përkatëse dhe jo ato të tepërta që vijnë si pasojë e regjistrimit të studentit në shkollë do të bëhet me qëllim të vendosjes, përsosjes dhe mbajtjes së marrëdhënies me Institutin shkollor për ndjekjen e qëllimeve institucionale të Institutit, si dhe të Ministrisë së Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit (MIUR) të parashikuara nga ligjet, rregulloret dhe legjislacioni i komunitetit, si dhe nga dispozitat e lëshuara nga autoritetet dhe organet mbikëqyrëse dhe kontrolluese.
Cilat janë garancitë që të dhënat e mia do të trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë e mia personale?	Trajtimi do të bëhet brenda zyrave të sekretarisë dhe ambienteve të shkollës në përgjithësi, në mënyrë manuale dhe kompjuterike. Për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave, do të zbatohen masa minimale të sigurisë organizative dhe asaj informatike, të cilat janë theksuar në "Dokumentin e masave për mbrojtjen e të dhënave personale" i përgatitur nga ky institucion arsimor. Instituti u ka dhënë personave përgjegjës udhëzime të sakta në lidhje me sjelljen që duhet të ndiqet dhe procedurat që duhet të zbatohen për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave të përdoruesve të tij. Me rastin e trajtimit mund të vihem në dijeni të të dhënave delikate me qëllim për të zbuluar gjendjen e shëndetit (çertifikata mjekësore, aksidente, përjashtime, diagnoza funksionale etj) dhe besime fetare (kërkesë për përdorim të festave fetare, dieta fetare, etj.) të cilat, së bashku me të dhënat e përcaktuara si "gjyqësore", përpunohen për qëllime të interesit të rëndësishëm publik që M.I.U.R. ndjek. Asnjë proces i automatizuar i vendimmarrjes (profilizim) nuk do të kryhet mbi to.
A do të jenë të dhënat e mia në dispozicion për subjektet e tjera?	Të dhënat personale të ofruara mund t'u komunikohen autoriteteve lokale, administratës së shkollës (MIUR, USR dhe UST), INAIL, ASL / ATS si dhe profesionistëve dhe furnizuesve që Instituti ynë përdor si RSPD, DPO, doktorit kompetent, kompanive të sigurimeve, agjensive të udhëtimeve, ekskluzivisht për qëllime institucionale. Në mënyrë të veçantë, të dhënat tuaja gjithashtu mund të komunikohen; për ata që janë përgjegjës për shërbimin e drekës shkollore (nëse ofrohet) për qëllime organizative të së njëjtës, organeve të jashtme për organizimin e veprimtarive edukative të llojeve të ndryshme, përfshirë udhëtimet edukative, fotografitë që përshkruajnë nxënësit mund të ekspozohen në ambientet e Institutit dhe në brendësi të klasave me qëllim të dokumentimit të veprimtarisë mësimore, të dhënat e administruara në mënyrë kompjuterike mund të shihen nga teknikët përgjegjës për kujdestarinë e tyre gjatë kontrollit dhe mirëmbajtjes së rrjetit dhe pajisjeve informatike, të dhënat e studentëve që ndjekin vitin e tetë të shkollës 8-vjeçare do t'i dërgohen Rajonit të Lombardisë për krijimin e "Regjistratit të Studentëve të rajonit të Lombardisë" të përmendur në Ligjin Rajonal 19/2007 për të zbatuar kontrollin mbi përmbushjen e detyrimit të arsimit dhe aftësisë. Të dhënat nuk do t'u komunikohen subjekteve të tjera që nuk tregohen shprehimisht në këtë dokument përveç nëse është marrë ose shpërndarë pëlqimi paraprak. Në rast transferimi, dosja personale do t'i dërgohet një institucioni tjetër marrës. Të dhënat <u>nuk do të transferohen</u> tek marrësit që jetojnë në vendet e treta ndryshe nga ata të Bashkimit Europian ose organizatat ndërkombëtare.
Për sa kohë do të ruhen të dhënat e mia?	Të dhënat do të mbahen në Institut për sa kohë që regjistrimi do të jetë aktiv dhe më pas, në rast transferimi në një institucion tjetër ose në përfundimin e marrëdhënies, vetëm të dhënat minimale do të ruhen për periudhën e mbajtjes së detyrueshme të parashikuar nga legjislacionin aktual.
Cilat janë të drejtat e mia?	Pala e interesuar ka të drejtë të pyesë Titullarin për trajtimin e të dhënave: - Qasje në të dhënat e tyre, korrigjimin ose fshirjen e tyre; - Kufizimi dhe kundërshtimi i përpunimit të të dhënave personale në lidhje me të; - Transportueshmëria e të dhënave; Pala e interesuar gjithashtu ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë autoritetit mbikëqyrës të vendit të banimit, si dhe të tërheqë pëlqimin për përpunimin në përputhje me nenin. 6 të G.D.P.R.
Çfarë ndodh nëse nuk i jap të dhënat e mia?	Mosdhënia e pëlqimit, dorëzimi i pjesshëm ose i gabuar i të dhënave mund të rezultojë në pamundësinë për t'i ofruar studentit të gjitha shërbimet e nevojshme për të garantuar të drejtën e tij për arsimim dhe aftësim.
Cili është Titullari i trajtimit të të Dhënave?	Instituti shkollor, me drejtorin në detyrë
Përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave	Luca Corbellini c/o Studio AG.I.COM. S.r.l. - Via XXV Aprile, 12 – 20070 SAN ZENONE AL LAMBRO (MI) e-mail dpo@agicomstudio.it



"Ministero dell'istruzione, dell'università e della ricerca"
 I.C.S. "Quintino Di Vona"
 Via L. da Vinci, 2 - 20062 Cassano d'Adda (MI)
 Cod. Min. MIIC8CC00P - C.F. 91548230159
 tel. 0363/60061 - fax 0363/361145 - e-mail: MIIC8CC00P@istruzione.it
 sito internet: www.icqdivona.it

Kopështi: Cristo Risorto Groppello Cascine S.P.

Fillorja: Q. Di Vona Groppello Cascine S.P. Guarnazzola

8-vjeçarja: Alessandro Manzoni

Të nënshkruarit

Prindër të nxënësit/es **Klasa :** **Seksoni:**

DEKLAROJNË SE KANË LEXUAR POLITIKËN E PRIVATËSISË DHE SHPREHIN MIRATIMIN E TYRE PER KËRKESAT E MËPOSHTME,

KËRKESE E SHFAQJES SË DAKORTËSISË TË PËLQIMIT NË BAZË TË ARTIKULLIT.7 TË RREGULLORES SË B.E

KËRKESA	MIRATOJ	NUK MIRATOJ
(VENDOSNI NJË X NË KOLONËN DJATHTAS NË BAZË TË ZGJEDHJES SË BËRË)		
Personeli i autorizuar i Institutit do të mund të fotografojë nxënësin me rastin e fotografisë vjetore të klasës që do t'i dorëzohet dhe familjeve të nxënësve të tjerë. Komunikimi, pëveçse duke dorëzuar fotografinë e stampuar, gjithashtu mund të bëhet me shpërndarjen e skedarëve (file) që riprodhojnë të njëjtat imazhe		
Personeli i autorizuar i Institutit do të jetë në gjendje të rregjistroj me ndihmën e mjeteve audiovizuale, si dhe të fotografojë studentin, për qëllime të lidhura rreptësisht me veprimtarinë mësimore. Rezultatet e këtij aktiviteti mund të publikohen në faqen e internetit të shkollës.		
Të dhënat e studentit, përfshirë ato që lidhen me gjendjen e tij shëndetësore, mund t'u komunikohen kompanive të sigurimeve në rast aksidenti të nxënësit për ushtrimin e procedurave të rimbursimit.		
Të dhënat personale të nxënësit mund t'u komunikohen institucioneve të tjera arsimore që i kërkojnë me qëllim që për të informuar në lidhje me ofertën e tyre të shërbimeve formuese.		

Vëndi dhe data

Mbiemri dhe emri i prindit të parë.....
 (*)

Firma

Mbiemri dhe emri i prindit të dytë.....

Firma

(*) Nëse informacioni në fjalë nënshkruhet nga një prind i vetëm, duke pasur parasysh nenet 316 paragrafi 1 dhe 337 ter paragrafi 3 të Kodit Civil, supozohet si miratim nga të dy prindërit.